

#3312

Udhëheqësit në kishën lokale

1 e Pjetrit 5:1–5; Eksodi 18:13–27

A mund ta hapim Biblën së bashku tek Eksodi 18? Eksodi 18, nga ku do t’ju lexoj prej vargut 13 e deri në fund të kapitullit. Në këtë kapitull, vjehrrri i Moisiut i jep atij këshilla:

“Por ndodhi që, të nesërmen, Moisiu u ul për të gjykuar popullin; populli u mbledh rreth Moisiut që nga mëngjesi deri në mbrëmje. Kur vjehrrri i Moisiut pa të gjitha ato që ky bënte për popullin, tha: ‘Ç’është kjo që bën ti me popullin? Pse ulesh vetëm dhe tërë populli të rri për qark nga mëngjesi deri në mbrëmje?’. Moisiu iu përgjigj vjehrrit të vet: ‘Sepse populli vjen tek unë për t’u këshilluar me Perëndinë. Kur ata kanë ndonjë problem, vijnë tek unë dhe unë gjykoj njërin dhe tjetrin, dhe u bëj të njohur kanunet e Perëndisë dhe ligjet e tij’. Por vjehrrri i Moisiut i tha: ‘Ajo që bën ti nuk është mirë. Do të rraskapitesh në fund, ti dhe ky popull që është me ty, sepse detyra që ke marrë përsipër është shumë e vështirë. Nuk mund t’ia dalësh në krye vetëm. Tani dëgjomë; unë do të të jap një këshillë dhe Perëndia qoftë me ty: përfaqësoje ti popullin përpara Perëndisë dhe paraqitja Perëndisë problemet e tyre. Mësoju atyre statutet dhe ligjet, dhe tregoju rrugën nëpër të cilën duhet të ecin dhe atë që duhet të bëjnë. Por zgjidh në mes të të gjithë popullit disa njerëz të aftë, që kanë frikë nga Perëndia, njerëz të besuar, që e urrejnë fitimin e padrejtë dhe vendosi mbi popullin si krerë të mijërave, krerë të qindrave, krerë të pesëdhjetërave dhe krerë të dhjetërave. Dhe lejo që të jenë ata që do ta gjykojnë popullin në çdo kohë; ata do të të parashtrojnë çdo problem me rëndësi të madhe, ndërsa për probleme të vogla do të vendosin vetë. Kështu do të jetë më e lehtë për ty, dhe ata do ta mbajnë peshën bashkë me ty. Në qoftë se ti vepron kështu, dhe kështu të urdhëron Perëndia, mund të mbaresh; dhe tërë ky popull do të arrijë faqebardhë në vendin e caktuar për të.’ Moisiu e dëgjoji zërin e vjehrrit të tij dhe bëri gjithçka që i kishte thënë. Kështu Moisiu zgjodhi në tërë Izraelin disa njerëz të aftë dhe i vuri si krerë të popullit: krerë të mijërave,

krerë të qindrave, krerë të pesëdhjetërave dhe krerë të dhjetërave. Kështu ata e gjykonin popullin në çdo kohë; çështjet e vështira ia parashtronin Moisiut, por çdo problem të vogël e zgjidhnin vetë. Pastaj Moisiu u nda nga vjehri i tij, i cili u kthye në vendin e vet.”

Amen.

Pasi lexuam nga Dhiata e Vjetër, ju ftoj tani të shkojmë në Dhiatën e Re, te 1 e Pjetrit kapitulli 5. Do t’ju lexoj 1 e Pjetrit 5:1-5:

“U bëj thirrje pleqve midis jush, unë bashkëplak dhe dëshmitar i vuajtjeve të Krishtit edhe pjesëmarrës i lavdisë që ka për t’u zbuluar: ruani tufën e Perëndisë midis jush, duke e mbikëqyrur jo me detyrim, por me vullnet të lirë, jo për përfitim të pandershëm, po me vullnet të mirë, dhe jo si zotërues mbi ata që ju janë besuar, por duke u bërë shembull për tufën. Dhe kur të shfaqet kryebariu, do të merrni kurorën e lavdisë që nuk fishket. Gjithashtu ju, të rinjtë, nënshtrojuni pleqve. Po, nënshtrojuni të gjithë njëri-tjetrit dhe vishuni me përulje, sepse Perëndia i kundërshton mendjemëdhenjtë, por u jep hir të përlurve.”

O Atë, ne lutemi dhe kërkojmë ndihmën tënde, ndihmën e Frymës së Shenjtë, ndërsa do të mendojmë për këto gjëra—ne vijmë para teje me dobësi dhe lutemi që të përjetojmë se ti je më se i mjaftueshëm për nevojat tona. Ne të lutemi në emrin e Jezusit. Amen.

Ju që jeni të vëmendshëm ndaj hollësive, do ta keni vënë re tashmë, që po bëjmë një pushim të shkurtër nga Efesianëve 6. Keni të drejtë. Ky nuk është një vendim arbitrar; në fakt, kjo është shumë e qëllimshme. Megjithatë, më lejoni të filloj kështu.

Një të diel, kohë më parë, kur arrita në Dublin dhe mora një makinë me qira, e kisha vendosur që doja të shkoja në kishë atje, doja të shkoja në një kishë të caktuar, të cilën më në fund e gjeta. Por nuk ishte e lehtë, sepse aftësia ime për t’u orientuar në qytet, u pengua fort nga një klerik tjetër—kleriku tjetër ishte vetë Papa, të cilin disa e konsiderojnë si “Zëvendësi i Krishtit”

mbi tokë. Kjo gjë më bëri të mendoj ndërsa po i jepja makinës. Fillova të mendoja për faktin që atë të diel të caktuar, në përgatitje për takimin tonë për të dielën e ardhshme, kur do të caktonim pleqtë në kishë—duke qenë se i kisha të dyja këto gjëra në mendjen time, thashë me vete: “Si vallë mund të kalojnë njerëzit nga udhëzimi i qartë i Dhiatës së Re te një strukturë hierarkike si ajo e Kishës Katolike Romane, ku, në fund të fundit, pushteti rrjedh realisht nga autoriteti i një individi të vetëm?”. Kjo më bëri të mendoja se sa e lehtë është që, kur njerëzit e Perëndisë nisin të lartësojnë urtësinë njerëzore mbi Fjalën e Perëndisë, sa lehtë dhe sa shpejt mund të shkojnë keq gjërat.

John Murray—i cili tani ka shkuar në qiell—kur ishte profesor në Seminarin e Uestminsterit (Westminster Seminary), bëri një deklaratë shumë domethënëse në lidhje me këto gjëra, kur po fliste për mënyrën se si na mëson Bibla për rëndësinë e udhëheqjes së përbashkët në kishë dhe se pse ishte kaq e rëndësishme që kjo gjë të ruhej në kishë. Pastaj, ai tha: “Nuk është habi”, që kur njerëzit nuk ecin sipas udhëzimit të qartë të Shkrimit, atëherë “hapat logjikë” të çojnë “në atë që mund të konsiderohet si shtrembërimi më i madh në historinë e krishterimit, domethënë, në pretendimet dhe blasfeminë e [papatit.]”¹

Kjo është një deklaratë shumë e fortë. Por ju jeni njerëz me mend dhe shpresoj që keni një Bibël të hapur para jush. Prandaj, ju keni të drejtë t’i lexoni Shkrimet dhe të vlerësoni si kohërat dhe mënyrën se si është shpalosur historia. Kjo nuk është e lehtë, pasi është një përgjegjësi e veçantë në sferën e katolicizmit roman. Është fakt që, në një shkallë më të ulët, protestantizmi është po aq i prirur ndaj së njëjtës arrogance dhe tiranie që i lartëson individët në pozita në të cilat nuk duhet të jenë kurrë. Ju mund të keni qenë në kisha të tilla, dhe Zoti na ruajttë që të mos bëhemi kurrë një kishë e tillë, sepse ka njëfarë prirjeje në zemrën e njeriut për të arritur në atë përfundim!

¹ John Murray, *Collected Writings of John Murray*, vëllimi 2, *Select Lectures in Systematic Theology* (Edinburgh: Banner of Truth, 1977), 346.

Do ta trajtojmë këtë temë shkurtimisht dhe në mënyrë përzgjedhëse sot, nën dritën e asaj që na pret si kishë. Asnjë kishë nuk mund të hamendësojë se do ta bëjë me siguri kalimin nga një brez te tjetri, nëse nuk tregon kujdes të veçantë për t'u siguruar që ata të cilët veçohen për ato përgjegjësi, të dallohen jo vetëm nga karakteristikat e përshkruara në Dhiatën e Re, por edhe nga kuptimi që kanë për doktrinën e krishterë dhe për vendin që u është caktuar. Është kështu, sepse historia e kishës e bën të qartë që kisha e Jezu Krishtit nuk përparon dhe nuk do të përparojë përtej përparimit frymëror të udhëheqësve të saj. Kisha nuk do të përparojë përtej përparimit frymëror të udhëheqësve të saj. Ja pse Dhiata e Re i jep një vlerë shumë të lartë vetë udhëheqjes—për shembull, kur Pali i shkruan letrën e tij të parë Timoteut, përse i thotë: “Kjo fjalë është e besueshme: Në qoftë se dikush dëshiron të bëhet peshkop”, ose të jetë një plak kishe, “punë të mirë dëshiron”²? “Punë të mirë dëshiron.”

Kur e lexoni Biblën tuaj, ju kuptoni që historia e Dhiatës së Re është historia se si lajmi i mirë i ungjillit depërtoi në komunitetet e asaj kohe, si rezultat i predikimit të apostujve. Ndërsa apostujt predikuan, njerëzit u kthyen në besim; ata u bënë ndjekës të Jezusit. Duke qenë se u bënë ndjekës të Jezusit, ata u mbledhën në bashkësi me njëri-tjetrin. Dhe ndërsa u mbledhën në bashkësi me njëri-tjetrin dhe filluan të lexonin, si fillim Shkrimet e Dhiatës së Vjetër, dhe të pyesnin se si do të funksiononin në vazhdimësi, si përmes praktikës, ashtu edhe përmes udhëzimeve të tyre, apostujt e bënë shumë të qartë që udhëheqja ishte jashtëzakonisht e rëndësishme. Prandaj, në librin e Veprave, ju lexoni herë pas here që Luka thotë: “Pali dhe Sila”, ose “Pali dhe Barnaba shkuan në këtë apo atë vend, dhe pasi predikuan ungjillin në atë qytet dhe bënë shumë dishepuj, u kthyen sërish aty për të caktuar pleq nëpër kisha.”³ Këta njerëz ishin nën autoritetin e Perëndisë dhe u

² 1 e Timoteut 3:1.

³ Shih, për shembull, Veprat 14:21–23.

ishte besuar privilegji dhe përgjegjësia që të siguroheshin se Fjala e Perëndisë po zbatohet, se Biri i Perëndisë po nderohet dhe se populli i Perëndisë po ndërtohet.

Kur lexojmë këtu, te 1 e Pjetrit 5, jemi në fund të letrës së tij, një letër të cilën ua kishte shkruar besimtarëve të shpërndarë të kohës së tij—ata të cilëve ai u referohet si “të zgjedhurve në diasporën e Pontit, të Galatisë, të Kapadokisë, të Azisë dhe të Bitinisë.”⁴ Ju edhe sot mund të gjeni një hartë apo një atlas, dhe t’i gjeni këto vende, edhe pse tani ato kanë emra të rinj dhe më të kohës. Ajo që kishte ndodhur, ishte që ata e kuptonin veten e tyre në një mënyrë krejtësisht të re. Ndërsa më parë ata e identifikonin veten sipas sfondit të tyre, sipas etnisë, sipas aftësive, sipas zanatit të tyre, e kështu me radhë—sepse kjo është mënyra se si njerëzit bëhen bashkë, apo jo? Në përgjithësi, njerëzve që u pëlqen të bëjnë palestër, shkojnë në palestër. Atyre që nuk u pëlqen, nuk shkojnë. Njerëzve që u pëlqen të vizitojnë libraritë dhe të rrinë aty deri pasdite vonë, duke menduar thellë, janë edhe ata një grup i veçantë.

Mirëpo, në komunitetin e krishterë nuk po ndodhte kjo, sepse në atë komunitet, gjeni disa njerëz që u pëlqen libraria dhe disa që u pëlqen palestra. Si vallë u njohën me njëri-tjetrin? E po, kjo gjë nuk ndodh në librari dhe as në palestër. Ku ndodhi? Në fakt, ata u takuan rreth tryezës së Darkës së Zotit. “Oh, tryeza e Darkës së Zotit! E ke fjalën për atë lloj vendi ku komuniteti portretizohet me të vërtetë?” Po, e saktë. Ata u takuan me njëri-tjetrin. Ata po bënë diçka shumë të çuditshme. Të gjithë ishin ulur bashkë si një grup dhe po dëgjonin një fjalim. Por kjo zor se ndodh në ndonjë vend në botën perëndimore. Edhe kur presidenti përpiqet të mbajë një fjalim, ai fjalim ndërpritet gjithë kohën nga duartrokitjet. Kurse këtu nuk dëgjohej duartrokitje—dhe nëse e bën, bie në telashe. Prandaj, pse ta bësh?

⁴ 1 e Pjetrit 1:1.

Mendoni për grupin. Shikoni se kush është ulur këtu. Çfarë ka? E po, Pjetër, na thuaj! E para e Pjetrit 2:9 thotë: “Por ju jeni fis i zgjedhur, priftëri mbretërore, komb i shenjtë, popull i fituar nga Perëndia.” E dalloni? Ai po përdor gjithë këto tablo nga Dhiata e Vjetër në lidhje me popullin e Perëndisë. Në letrën e tij, Pjetri po bën atë që Pali bën diku tjetër: ai po e lartëson mrekullinë e faktit që, në Jezusin, Perëndia mori dy njerëz, nga të dy këta bëri një njeri të ri.⁵ Ata e gjejnë veten e tyre në këtë kontekst—qofshin nga grupi më i arsimuar, apo nga ai më pak i arsimuar, dhe pavarësisht nëse janë nga e njëjta prejardhje etnike—ata po këndojnë të njëjtat këngë, ata po këndojnë bashkë të njëjtat psalme, po i nënshtrohen së bashku Shkrimeve, dhe së bashku po shohin drejt Zotit.

Në atë kontekst dhe në atë komunitet zbatohen parimet e udhëheqjes së kishës. Kur ne bëjmë pyetjen—dhe e gjejmë përgjigjen në Bibël—“Si duhet të funksionojë kisha?”, atëherë nuk mund të kemi pikë dyshimi. Gjatë Veprave të Apostujve, modeli është që burrat dhe gratë ktheheshin në besim, kishat themeloheshin dhe caktoheshin pleq. Ja pse këtu te 1 e Pjetrit 5 lexojmë: “U bëj thirrje pleqve midis jush.” Ai thotë: “Unë jam plak bashkë me ju, dhe ja se çfarë duhet t’ju them.”

Në këtë pjesë, ai nuk po trajton kualifikimet e pleqve. Ai është duke u marrë me administrimin e pleqësisë së kishës. Kualifikimet mund t’i lexoni te 1 e Timoteut 3 dhe në vende të tjera. Mirëpo, këtë mëngjes nuk do të flas për këtë temë. Dua t’ju jap katër fjalë në lidhje me udhëheqjen. Ja ku i keni: duam të mendojmë për udhëheqjen, si *pastorale*, *llogaridhënëse*, e *përbashkët* dhe *frymërore*. Do ta kalojmë shpejt secilën prej tyre.

⁵ Shih Efesianëve 2:14–15.

Udhëheqje pastorale

Më së pari, udhëheqja është një shërbesë e dukshme dhe e qartë *pastorale*. Do të vini re që, në vargjet e para të 1 e Pjetrit 5, nga sa mund t’ju tregoj bazuar mbi njohjen time të Dhiatës së Re në greqisht, është që, në terminologjinë e përdorur në këto vargje, Pjetri është duke i përdorur fjalët në mënyrë të ndërsjellë, për të sqaruar natyrën e kësaj udhëheqjeje pastorale. Për shembull, herën e parë që shihni fjalën “pleq” në ato vargje, që në greqisht është *presbuteroi*, nga e cila vjen fjala *presbiter* ose *presbiterian*. Kjo është një fjalë që shpreh më së shumti idenë e pjekurisë frymërore. Pjekuria frymërore mund të mos jetë domosdoshmërisht e lidhur me moshën e personit, sepse duket qartë se është e mundur që të kesh njerëz në moshë të madhe, të cilët të jenë ende relativisht të papjekur. Po kështu është e mundur që të jesh i ri dhe të kesh ecur shumë me Perëndinë. Kjo, pra, është çështja e pjekurisë.

Pastaj, Pjetri i nxit me fjalët “ruani tufën e Perëndisë”. Folja që përdoret atje është një folje e zakonshme për gjithë atë ide. Në fakt, kjo flet për përgjegjësinë e veçantë të asaj që po ndodh. E thënë ndryshe, nëse përdor atë fjalë “bari” ose “pastor”, ajo e heq menjëherë çështjen thjesht nga sfera e administrimit apo nga të qenët në gjendje për të përdorur disa dhunti të caktuara, të cilat mund të jenë pjesë e jetës së përditshme të një individi. Me të apo pa të, roli është të ruajnë tufën.

Dhe së treti, për të treguar mbikëqyrje, siç do ta shihni: “duke e mbikëqyrur”. Fjala që përdoret këtu, është *episcopoi*, që siç mund ta dalloni dhe vetë, na jep fjalën *episkopal*. Prandaj, kur ne i përdorim këto fjalë, në fakt, jemi duke folur për ushtrimin e të njëjtit ofiq. Atë që e gjeni te 1 e Pjetrit, e gjeni gjithashtu edhe te Letra e Hebrenjve. Te Hebrenjve 13 thuhet: “Kujtoni udhëheqësit tuaj”, dhe pastaj thotë se ajo që ata bënë, ishte që “ju thanë fjalën e Perëndisë”.⁶ Çfarë bëjnë pleqtë? Ata ju flasin Fjalën e Perëndisë. “Oh, jo, a nuk e bën pastori këtë?” E po, pastori

⁶ Hebrenjve 13:7.

është thjesht njëri nga pleqtë. Të gjithë pleqtë duhet të jenë në gjendje t’jua flasin Fjalën e Perëndisë. Kjo nuk do të thotë që ata e flasin atë nga *këtu*. Por do të thotë që, nëse u drejtohesh atyre, ata do të jenë në gjendje të shkojnë te Shkrimet bashkë me ju dhe do të jenë “të aftë të japin mësim”.⁷ Ata ju folën Fjalën e Perëndisë, ata ju udhëhoqën. Prandaj, ja si qëndron puna: ata duhet t’ju ushqejnë dhe t’ju udhëheqin. Më poshtë në këtë pasazh, ai thotë: “Duhet të jeni të vetëdijshëm për faktin që ata vigjëlojnë mbi shpirtrat tuaj.”⁸ Pra, udhëheqësit ekzistojnë për t’ju ushqyer dhe për t’ju udhëhequr, për t’ju mbikëqyrur dhe për t’ju paralajmëruar. Këtë duhet të bëjnë udhëheqësit: “të rrinë syhapur mbi shpirtrat tuaj”.⁹

Sikurse ka thënë edhe Pjetri këtu, mënyra se si duhet të ndodhë kjo, është njëkohësisht sfiduese dhe e dobishme. Ata duhet të mbikëqyrin. Vini re tre *jo* dhe pastaj një *por*: “jo me detyrim, por me vullnet të lirë”; “jo për përfitim të pandershëm, por me vullnet të mirë”; “jo si zotërues mbi ata që ju janë besuar, por duke u bërë shembull për tufën”. Kjo është shumë e rëndësishme, apo jo? Duke qenë se ai tashmë ka thënë se kushdo që dëshiron të bëhet peshkop—të paktën Pali e ka thënë—“punë të mirë dëshiron.” Por pastaj duhet të thoni: “E po, pse të më *pëlqejë* të jem një plak kishë? Pse të përgatitem për ta lejuar dikë që të ma besojë këtë privilegj? Kam nevojë që, të paktën, ta kontrolloj veten në këto zona. Mos është vallë për shkak se dëshiroj të zotëroj? Mos mendoj se ka një mënyrë se si ta përdor këtë gjë si një mekanizëm për fitim? A jam me të vërtetë i gatshëm ta bëj këtë?”

Udhëheqje llogaridhënëse

Të gjitha ato janë pyetje shumë të rëndësishme, sepse udhëheqja është pastorale, por, së dyti, ajo është edhe *llogaridhënëse*. Udhëheqja është llogaridhënëse. Plaku i kishës, i cili e merr

⁷ 1 e Timoteut 3:2.

⁸ Hebrejve 13:17 (parafrazim).

⁹ Hebrejve 13:17.

seriozisht këtë thirrje, jeton nën trysninë e vazhdueshme, siç thotë edhe Pjetri, të të diturit që “Kryebariu”—në vargun 4—do të shfaqet; dhe do të ketë një “kurorë lavdie që nuk fishket”. Dakord, kjo është shumë inkurajuese; kjo është diçka që duhet pritur. Ama kur ai të shfaqet, ne do të “japim llogari”. Pleqtë e kishës rrinë syhapur mbi shpirtrat tuaj, si ata që duhet të japin llogari.

Tani, ne të gjithë i japim llogari njëri-tjetrit. Ka një llogaridhënie reciproke, e cila ekziston brenda trupit të Krishtit. Por këtu po flitet për diçka tjetër. Ajo që Dhiata e Re na mëson, nuk është ndonjë formë demokracie—sigurisht që nuk është as autokraci, si ajo në strukturat hierarkike—por Dhiata e Re na mëson teokracinë. Me fjalë të tjera, Perëndia ushtron sundimin e tij vetëm përmes Birit të tij, i cili është Kryebariu, me anë të Frymës së Shenjtë, nëpërmjet Biblës, në mënyrë që populli i Perëndisë të mësohet nga Fjala e Perëndisë, të udhëhiqet nga Fjala e Perëndisë, të përkushtohet ndaj Fjalës së Perëndisë dhe ta kuptojë rëndësinë e Fjalës së Perëndisë. Ja pse ne bëjmë atë që bëjmë. Pse vallë vazhdojmë ta studiojmë Biblën sërish nga fillimi në fund? “Për sa kohë do të vazhdosh ta bësh këtë?” Tani e përjetë! Për aq kohë sa të marrim frymë. Pse? Sepse nga kjo varet e ardhmja e kishës! Duket qartë kur ka mungesë të udhëheqjes dhe ushqyerjes së popullit të Perëndisë nga ata që janë veçuar për këtë detyrë, dhe kjo gjë është tragjike.

Ja pse te 1 e Korintasve 4, kur mendon për këto gjëra, Pali thotë disa fjalë shumë të dobishme, “Kështu njeriu, le të na mbajë për shërbëtorë të Krishtit dhe administratorë të mistereve të Perëndisë. Dhe tjetra që kërkohet nga administratorët, është që secili të gjendet *besnik*.” Jo domosdoshmërisht të suksesshëm. “Sa për mua, më intereson fort pak që të gjykojem prej jush ose prej dite gjyqi njerëzor; madje as vetveten nuk e gjykoj. Sepse nuk jam i vetëdijshëm për asnjë faj, por për këtë nuk jam justifikuar, por ai që më gjykon është Zoti.”¹⁰

¹⁰ 1 e Korintasve 4:1–4.

Prandaj, kur Shkrimet thonë që “ata rrinë syhapur mbi shpirtrat tuaj, si ata që duhet të japin llogari”,¹¹ aty nuk po flitet që do t’ju japin llogari *juve*: nëse ju pëlqeu predikimi, nëse menduat se ishte shumë i gjatë ose shumë i shkurtër; nëse ju pëlqeu personaliteti i plakut të kishës; nëse ju pëlqeu mënyra se si ndodhën pagëzimet; apo ndonjë gjë tjetër si kjo. Kjo është në rregull; mund t’i bëjmë të gjitha këto biseda, dhe më shumë se kaq. Jo, këtu flitet për diçka shumë më të rëndësishme. Mendoni pak, do të jepni llogari për të gjitha fjalët që thatë nga foltorja. Për çdo këshillë private do të jepni llogari. Do të jepni llogari për çdo herë që bëtë shaka për Biblën, në vend që të tregoheshit seriozë. Do të jepni llogari për çdo herë që i paraqitët dikujt një mënyrë të jetuari të cilën nuk e ndoqët vetë. Kush do të japë llogari? Ata të cilëve u është besuar udhëheqja. Shumë të dashur, a e kuptoni se çfarë po bëjmë kur i veçojmë njerëzit për rolet e udhëheqjes në kishën tonë?

Udhëheqje e përbashkët

Udhëheqja nuk është vetëm pastorale dhe llogaridhënëse, por ajo është edhe *e përbashkët*. Udhëheqja është e përbashkët. Një pjesë të mirë të kësaj do t’ju lë ta studioni vetë. Mund ta hetoni vetë këtë; nuk është e vështirë ta gjeni. Por Kryebariu, domethënë Jezusi, cakton nënbarinj për ta udhëhequr tufën e tij me kërrabën e Fjalës së tij. Kjo, pra, është tufa e tij, dhe Fjala e tij është kërraba me anë të së cilës ne korrigjojmë, nxitim, inkurajojmë e kështu me radhë.

Duke qenë se kjo përgjegjësi nuk bie mbi një individ, por mbi një grup, është e rëndësishme të kuptojmë që kërkesat janë kërkesa të përbashkëta. Nuk ka një standard për njërin dhe një standard për tjetrin—jo! Kërkesat janë të përbashkëta, privilegjet janë të përbashkëta dhe përgjegjësitë janë të përbashkëta. Mirëpo, nuk është e njëjta gjë sikur të thuash që, të gjithë ata që

¹¹ Hebrenjve 13:17.

janë pjesë e pleqësisë së një kishe lokale, kanë të njëjtat dhunti. Sepse duket qartë që nuk është kështu! Këtë e dimë. Nëse do të merrje një grup të rastësishëm nga një bashkësi, do të zbuloje që mes tyre ka larmi. Prandaj, ndjesia e barazisë që e shijojmë para Perëndisë, ndjesia e barazisë dhe e reciprocitetit të cilat janë pjesë e përgjegjësisë së përbashkët, nuk e përjashtojnë larminë e dhuntive. Prandaj, kur ne themi se pleqtë e kishës janë të barabartë me njëri-tjetrin—që nuk do t'i konsiderojmë ata kurrë të shkëputur nga njëri-tjetri—nuk po themi që të gjithë ata mund të bëjnë gjithçka. E themi këtë, sepse ata nuk mundën. Asnjëri prej nesh nuk mund të bëjë dot gjithçka. Ja pse ekipi është kaq i rëndësishëm.

Mirëpo, kur lexojmë Biblën dhe Ungjijtë, kuptojmë se gjithmonë ka udhëheqës mes udhëheqësve. Merrni njëmbëdhjetë djem dhe mblidhni bashkë në një ekip futbollit. Lëri të luajnë për njëfarë kohe dhe ata do të zgjedhin një kapiten. Ata do të zgjedhin një kapiten. Kjo do të bëhet e dukshme. Prandaj, Jezusi thirri dymbëdhjetë, dhe më pas njohim Pjetrin, Jakobin dhe Gjonin. Këta të tre ishin me Jezusin mbi malin e shpërfytyrimit.

Kështu, kur mendojmë në lidhje me udhëheqjen e përbashkët, kemi nevojë të dallojmë gjithashtu se ka një dallim në funksion—një dallim, në fakt, të cilit Dhiata e Re i kushton vëmendje. Letra e Parë e Timoteut 5:17 thotë: “Pleqtë që qeverisin mirë, le të nderohen dyfish”—ja ku është dallimi—“sidomos ata që mundohen në fjalë e mësim.” “Sidomos ata që mundohen në fjalë e mësim.”

Për shembull, nëse merrni udhëheqjen në kishën tonë, jo të gjithë mundohen në predikim dhe mësim. Disa prej nesh po, por mendoj që, po aq të tjerë nuk janë të përfshirë. Prandaj, dallimi nuk ia ngre statusin personit para Perëndisë, madje as para bashkësisë. Neve që përfshihemi në mësim dhe predikim, mund të na pëlqejë të mendojmë kështu, por jo, nuk mendoj se mund ta themi këtë bazuar te Dhiata e Re. Kjo është vërtet shumë e rëndësishme, duke qenë se ekziston një tundim

shumë i veçantë, i cili ka të bëjë me faktin që të besohet privilegji i epërsisë së dhënies mësim të Biblës. Kjo është një gjë shumë shkatërrimtare, por edhe shumë oportuniste.

Atëherë, çfarë do ta mbrojë personin që mban Biblën në duar dhe e shpall atë me buzët e tij, që të mos bëhet një kopuk arrogant, tiran, zotërues dhe autokrat? “E po”, ju thoni, “e po, znj. Jenkins, ajo mund ta trajtojë këtë problem. Ajo e bëri me pastorin e kaluar.” Jo. Ajo nuk do të mjaftojë për ta zgjidhur këtë problem. Masat korrigjuese janë të përfshira në vetë udhëheqjen, prandaj është përgjegjësia dhe privilegji i pleqve që së bashku të sigurohen që asnjëri nga ne të mos përfundojë në atë pozitë. Për këtë arsye, edhe pse dikush mund të jetë në gjendje të udhëheqë me një lloj zelli bindës, në të njëjtën kohë, individë të tillë kanë nevojë që t’u nënshtrohen dukshëm bashkëpleqve të tyre, sepse ata janë po aq përgjegjës para Perëndisë, të cilit do t’i japin llogari. Pjesë e llogarisë që ata do të japin, është të sigurohen që asnjëri prej tyre, kushdo qoftë ai, të mos përfundojë në një pozitë të tillë mbizotëruese.

Udhëheqje frymërore

Udhëheqja, pra, është pastorale, llogaridhënëse, e përbashkët dhe, së fundi, është e qartë që ajo është *frymërore*. Udhëheqja është frymërore. Pleqësia e kishës është frymërore. Pse luten kaq pak njerëz? E po, kjo është një çështje frymërore. Pse vallë të kënduarit është kaq për të ardhur keq? Pasi kjo është një çështje frymërore. Pse numri i besimtarëve është në rënie? Pasi kjo është një çështje frymërore. Pse duket se ka një mungesë interesi për *këtë* apo *atë* gjë? Kjo është *gjithmonë* një çështje frymërore.

Ju e kuptoni që kisha nuk është një organizatë. Nuk po përpiqemi të krijojmë një klub. Kjo është kisha për të cilën Jezusi derdhi gjakun e tij. Kjo është kisha e Jezu Krishtit në një vendndodhje të caktuar. Prandaj, cila është përgjegjësia dhe roli i bashkësisë? Sërisht, Letra e

Hebrenjve na ndihmon në këtë pikë. Çfarë duhet të bëjmë? E po, ne duhet t'i duam udhëheqësit që na thanë Fjalën e Perëndisë, dhe “duke vështruar rezultatin e jetës së tyre”, ne duhet të “imitojmë besimin e tyre”.¹² Jashtëzakonisht e dobishme, apo jo? E thënë me fjalë të tjera: Si po funksion për ata vetë, kjo për të cilën po na flasin neve? A po sjell një ndryshim në jetën e tyre? Nëse nuk po sjell një ndryshim në jetën e tyre, atëherë nuk mund të jemi të sigurt që, me të vërtetë, po na thonë Fjalën e Perëndisë. Çfarë duhet të imitojmë ne? Personalitetin apo ndonjë gjë tjetër tek ata? Jo, jo, jo. Ne duhet të “imitojmë besimin e tyre”. Fakti është që, kur vijnë vështirësitë dhe errësira, kur rreziku na mbështjell, kur humbasim të afërmit, kur vetë sëmuremi nga kjo apo ajo sëmundje, ku janë këta njerëz? A po na thonë sërish që “Jezu Krishti është i njëjtë dje, sot dhe në përjetësi”?¹³ “E po, po, ata po na thonë.” Prandaj, unë dua që t'i “kujtoj” ata, dua që t'i “vështroj”. Sipas asaj që thuhet më poshtë, në të njëjtin kapitull, unë dua t'i “dëgjoj” dhe t'u “bindem atyre”.¹⁴ Pse? Sepse më pëlqejnë shumë? Jo. Por sepse thuhet që ata “rrinë syhapur mbi shpirtrat tuaj, si ata që duhet të japin llogari”.¹⁵

Në fakt, kjo na çon në fillim fare, te studimet tona nga Efesianëve 5 dhe 6. E mbani mend kur i studiuam këta kapituj dhe thamë: “Gratë duhet t'u nënshtrohen burrave të tyre.”¹⁶ Kultura në të cilën jetojmë, nuk është se zbrapset nga kjo gjë; përkundrazi, ajo e sulmon. Prandaj, kur keni njerëz që bëhen anëtarë të kishës suaj, të cilët nuk janë gati të jetojnë brenda sistemit të caktuar nga Perëndia për jetën familjare, dhe pastaj i vendosni ata njerëz në kontekstin e jetës së kishës, ata nuk e kuptojnë parimin e nënshtrimit në familjet e tyre. Çfarë mundësie mendoni se keni, që ata ta kuptojnë parimin e nënshtrimit në kishë? Kjo është arsyeja pse ndonjëherë njerëzit—sidomos

¹² Hebrenjve 13:7.

¹³ Hebrenjve 13:8.

¹⁴ Hebrenjve 13:17.

¹⁵ Hebrenjve 13:17.

¹⁶ Shih Efesianëve 5:22–24.

zonjat—janë shumë të zhgënjyer kur vijnë këtu, dhe që në fillim pyesin: “Do të doja të isha plak në këtë kishë”, dhe ne u themi: “Na vjen keq, nuk mund të jeni plak kishe.” “Pse?” “Sepse vetëm burrat duhet të jenë në udhëheqjen e kishës.” Pastaj bëjmë një diskutim të madh dhe të gjatë, i cili arrin në diskutimin e vetë Biblës. Ata thonë: “E po, Jezusi nuk e tha kurrë këtë. Këtë e tha Pali.” Unë u them: “Po. Pali shkroi Dhiatën e Re, nën drejtimin e Frymës së Shenjtë.” Dhe kështu vazhdon debati.

Prandaj, ideja e nënshtrimit është e vështirë, ama është e qartë. Kjo nuk e hedh poshtë idenë e nënshtrimit reciprok, i cili duhet të jetë pjesë e qenësishme e marrëdhënieve tona me njëri-tjetrin, dhe shkrimtari i Hebrenjve nuk po na nxit që të tregojmë ndonjë lloj bindjeje pa tru. Kështu portretizohet shpesh kjo gjë: “E po, nuk do ta lë trurin tim mënjane dhe të dëgjoj këtë.” Jo, jo, jo. Në vargun 9, ai tashmë ka thënë: “Mos e lëshoni veten aty-këtu prej doktrinash të ndryshme dhe të huaja.” E thënë me fjalë të tjera: Vazhdoni ta përdorni trurin. Vazhdoni të mendoni. Vazhdoni ta sillni Biblën me vete në kishë. Vazhdoni ta lexoni Biblën në grupin tuaj të vogël. Vazhdoni të siguroheni që udhëheqja e kishës po e ushtron qeverisjen, e cila është qeverisja e vetme, sundimi i vetëm i Krishtit, mbretërimi i vetëm i Krishtit, me anë të Frymës së Shenjtë dhe nëpërmjet Biblës. Kjo nuk është një çështje personaliteti. Jo! Nënshtrimi që kërkohet, është ndaj qeverisjes që ushtrohet në emrin e Jezusit, nën drejtimin e Jezusit dhe me standardin e Fjalës së tij. Nëse ndodh, dhe atëherë kur ndodh, që udhëheqja në kishë të largohet nga këto udhëzime biblike, ajo nuk meriton as bindje dhe as nënshtrim. Për këtë arsye, udhëheqësit identifikohen si “ata që u thanë fjalën e Perëndisë”.

Në shekullin e tetëmbëdhjetë, John Newton-i i tha bashkësisë së tij një mëngjes:

E [konsideroj] nderin dhe lumturinë time që i predikoj një populli të lirë, i cili e ka Biblën në duart e veta. Unë u drejtohem Biblave tuaja. Ju përgjërohem! Ju përbetohem që të mos pranoni asnjë nga fjalët e mia, për aq kohë sa unë nuk mund ta vërtetoj nga fjala e Perëndisë;

dhe që ta matni me të njëjtin standard çdo predikues dhe çdo predikim që dëgjoni.¹⁷

Struktura e vetme është si një trup pa frymë. Ja pse zbatimi frymëror i këtyre parimeve biblike është një gjë kaq e rëndësishme.

Meqenëse sapo jam kthyer nga ana tjetër e oqeanit dhe kam parë se sa lehtë dhe shpejt traditat mund të bëhen baza e një forme fosilizimi, madje edhe brenda atyre që ishin kisha të mira lokale, dua t’ju them sërish që nëse interesoheni për mirëqenien e kishës “Parkside”—jo vetëm *sot*—por edhe nëse Zoti nuk kthehet pas dhjetë, njëzet apo tridhjetë vjetësh, të kuptoni diçka: emërimet në Gjykatën e Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës *nuk krahasohen* me zgjedhjen e udhëheqjes së kishës lokale, në mënyrë që brezat të cilët nuk kanë lindur ende, të rriten, të udhëhiqen, të ushqehen, të mbikëqyren dhe të paralajmërohen, si rezultat i vendimeve të marra tani, në një moment të caktuar në kohë, që do të ketë ndikim jetëgjatë në histori dhe që, në fakt, kanë një rëndësi të përjetshme.

Ne themi bashkë me shkrintarin e himnit,

O Frymë e Jetës, eja fryj mes nesh,
Rizgjoje kishën tënde me jetë dhe fuqi;
O Frymë e Jetës, eja, na pastro e ripërtëri,
Dhe pajise kishën tënde të dëshmojë në këtë moment.¹⁸

Dhe atij që mund t’ju ruajë nga çdo rrëzim dhe t’ju vërë të paqortueshëm dhe me ngazëllim para lavdisë së tij, të vetmit Perëndi të urtë, Shpëtimtarit tonë, i qoftë lavdi dhe madhështi, sundim dhe pushtet, edhe tani, edhe në përjetësi. Amen.

¹⁷ John Newton, “Of a Living and a Dead Faith,” në *The Works of John Newton* (1820; ribotuar në Edinburgh: Banner of Truth, 1985), 2:558.

¹⁸ Bessie Porter Head, “O Breath of Life” (1920).